

VIZIONI USHTARAK I GJENERALIT MEHMET PASHË DERALLA

Flogert LILA & Orest RADHIMA

UDK: 355.1:323.1(496.5)

Abstrakt

Në këtë punim do të paraqesim një historik të shkurtër për veprimtarinë e Mehmet Pashë Derallës. Kjo figurë e shtetit shqiptar, e cila akoma nuk është vlerësuar aq sa duhet deri në këto momente për gjithë veprimtarinë e tij dhe kontributin që ka dhënë në formimin e shtetit shqiptar dhe mbrojtjen e tokave nga synimet e fqinjëve tanë për t'i pushtuar. Akoma nuk është bërë një punim që të jetë i denjë për këtë figurë. Disa historianë tanë deri më tani kanë shkruar më shumë për tradhtarët siç ishte Esad Pashë Toptani, i cili më shumë interesohet për pushtetin e tij, ndërsa për shumë figura të cilat me të vërtetë kanë dhënë kontribut të pastër për atdheun, nuk kanë marrë akoma shpërblimin moral. Do të duhet akoma shumë punë për të treguar në pah figurën e vërtetë të Mehmet Pashë Derallës. Shpresojmë që me këtë punim të kemi dhënë një kontribut sado të vogël për këtë figurë historike të popullit shqiptar.

Fjalë kyçe: veprimtaria e Mehmet Pashë Derallës, historia e tij, Shqipëria

Hyrje

Mehmet Deralla u lind më 1843, në Gradec të Tetovës, në familjen e dëgjuar të Hasan Pashë Derallës, ku patriotizmi ishte i gatuar që në rrënjë. Mehmeti kreu arsimin fillor në Tetovë (vendlindje), kurse shkollën e mesme e kreu në Shkup. Pas shkollimit në vendlindje, ndoqi studimet e larta në Akademinë Ushtarake të Stambollit, të cilat i përfundoi me rezultate të shkëlqyera, çfarë ndikoi që për disa vite të shërbente në Anadoll, i emëruar në një regjiment këmbësorie. Këtu u vlerësua “i zellshëm, me perspektivë”. Më pas iu dha e drejta për të ndjekur shkollën e lartë, Akademinë e Shtatmadhorisë në Stamboll, që ishte niveli më i lartë i arsimimit ushtarak në Turqi. Përfundimi i akademisë së Shtatmadhorisë i hapi dyert për karrierë të mëtejshme dhe fitimin gradualisht edhe të gradave madhore. Falë aftësive dhe shkallës së lartë të përkushtimit në të gjitha detyrat e ngarkuara, do ta bënin Mehmetin që në moshën 35-vjeçare të fitonte kualitetet e titullit të “Pashait”, që nënkuptonte atë të gjeneralit. I graduar kështu me gradën më të lartë të kohës do të niste nga detyrat e reja që do t’i besonte komanda e lartë, fillimisht si komandues xhandarmërie në Bagdad të Irakut dhe, më vonë, në Halep të Sirisë për t’u transferuar më tej në Selanik, i cili në atë periudhë përfaqësonte një nga portet më të rëndësishme të Perandorisë Osmane në Ballkan. Prej Selanikut, Mehmet Pashë Deralla, do të merrte emërimin në vilajetin e Kosovës për të shërbyer në kryeqendrën e tij, në Shkup, për të vijuar më vonë në funksionin e komandantit të qarkut të Prizrenit, në të cilin bënte pjesë edhe Tetova, Gjakova dhe Luma. Pikërisht me këtë detyrë, gjeneral Deralla do t’i jepte fund karrierës si oficer i Ushtrisë osmane. Më tej, për të fillon një karrierë tjetër, me një profil të ri. Ai në shenjë proteste hoqi spaletat dhe yjet e gjeneralit të Ushtrisë turke dhe iu përkushtua çështjes kombëtare. Mehmet pashë Deralla ishte atdhetar i flaktë, i zgjuar, nuk duronte dot intrigat e huaja. Nga ky shkak nuk u pajtua me qeverinë e Stambollit. Periudha e Rilindjes Kombëtare fillon nga mesi i shekullit XIX. I ndikuar nga ideologjia e rilindësve, Mehmet Deralla e intensifikoi

veprimtarinë e vet në funksion të një kauze, historikisht të drejtë. Më tej, ai do të lidhet me patriotët Haxhi Zeka, Bajram Curri, Ramadan Zaskoci e Idriz Seferi, duke u përfshirë gjerësisht në problemet kombëtare shqiptare. Mehmet Deralla, në kulmin e karrierës së gjeneralit të ushtrisë turke çmoi më të rëndësishme atdhetarinë dhe fatin e Shqipërisë se sa zbukurimin e supeve me spaleta e grada dhe kraharorin me medalje heroizmi osmanlinjsh.

Pas këtij momenti gjenerali u vu në dispozicion të Ushtrisë Vullnetare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Jemi në kohën kur Lëvizja Kombëtare Shqiptare kulmonte një moment historik. Në këtë lidhje u bisedua për të krijuar ushtrinë që do të mbronte trojet shqiptare. “Për të mbrojtur Gucinë e Rugovën, do të dërgohet nga fuqia e Gjakovës 2000 shpirte për Gucinë dhe nga Peja 2000 për Rugovën. Për të mbrojtur Gjakovën detyrohen vendasit vetë, kurse në Kollashin përveç vendasve do të dërgohen edhe 1000 burra nga ushtria që do të mblidhet në Jenipazar. Për të mbrojtur Prepoljen, Kajnicën, Tashllixhen e Foçën, mbasi vendasit nuk mjaftojnë do të dërgohen 2000 shpirte nga fuqia e Jenipazarit. Në Hercegovinë do të mblidhet një ushtri prej vendasve e përbërë prej 30.000 e do të ruajë vendet prej Grackos deri në Trebinjë. Vija Pallanka-Prepolje, do të mbrohet prej regjimentit të Jenipazarit dhe Prepolja prej atij të Sarajevës. Prej Jenipazarit do të ngrihet një ushtri, e përveç vendasve do të dërgohet atje dhe një sasi prej 20.000 shqiptarësh dhe ajo që do të ngrihet në Jenipazar, do të bashkohet me një tjetër ushtri. Në Shkup do të formohet një ushtri e cila, duke u bashkuar me atë të Kosovës, do të shkojë në Pallanka dhe në Vranjë. Numri i kësaj ushtrie do të jetë 4000 vetë. Ushtria e Shkodrës duhet të arrijë në 3000. Me këto formohet fuqia e ushtrisë kombëtare (pa atë të Sarajevës), 180.000 burra me 38 batalione (142.000 këmbësorë dhe 38.000 kalorës). Për të pasur fuqi të plotë, si në kohë lufte ashtu edhe paqe, të gjithë ne po vulosim dhe po nënshkruajmë: Iljaz Pashë Dibra, Mehmet Sadik Pashë Hoxholli, Ahmet Sabri Karahasani, Ismail Ethem Bajrami, (delegatët e Dibrës), Abdulla Pashë Dreni, një nënshkrim që nuk lexohet, Mehmet Kahraman,

Mehmet Shaqir, (delegatët e Gjakovës). Riza Fuad, Mehmet Pasha, Hasan Pashë Deralla, Sheh Mustafa, Sadik Mehmeti (delegatët e Tetovës) etj.”³⁸⁶ Duket qartë se të gjithë këta persona, të cilët kishin hedhur firmën, mbanin një përgjegjësi të madhe mbi supe, një pjesë të kësaj përgjegjësie e mbajti edhe Mehmet Pashë Deralla, por fatkeqësisht gjatë gjithë këtyre viteve nuk është shkruar aq sa duhet për këtë figurë historike. Ai mori përgjegjësi e luajti rol të rëndësishëm, krahas burrave të shquar të Lidhjes së Prizrenit, për organizimin e veprimeve luftarake të saj.

Mehmet Pashë Deralla u caktua këshilltar i Sulejman Vokshit, i cili bënte detyrën e ministrit të Mbrojtjes të kabinetit qeveritar, në të njëjtën linjë vazhdon aktiviteti atdhetar i Mehmet Derallës edhe pas shtypjes së Lidhjes së Prizrenit nga ushtria osmane, e dërguar nga Stambolli. Më 1899, Deralla do të kontribuonte në Lidhjen e Pejës, ku u mblodhën 450 delegatë, duke dëshmuar edhe një herë tjetër përpjekjet e personaliteteve shqiptare, të organizuar nën drejtimin e Haxhi Zekës, për të realizuar atë që nuk mundi ta bënte Lidhja e Prizrenit. Mehmet Deralla mbështeti këtu Haxhi Zekën, u bë njëri nga prijësit popullor, ndihmoi në hartimin e programit të kuvendit prej 11 pikave dhe “aktit të besës” me 12 nene, si dhe apelit “Rruga e shpëtimit është në besa-besën”. Sidoqoftë, përballë ushtrisë osmane, kjo lëvizje detyrohet të dështojë. Burime të tjera evidentojnë se ai u caktua komandant i Forcave Ushtarake të Lidhjes së Prizrenit për viset e Maqedonisë, vlerësuar edhe kjo si një zonë me rëndësi strategjike. Më 5 korrik 1908 rezulton të ketë qenë pjesëmarrës në kuvendin e Ferizajt dhe nënshkrues i telegramit që iu dërgua sulltanit, ku kërkohej rivendosja e kushtetutës së vitit 1876. Më pas, ka qenë në Stamboll në cilësinë e anëtarit të komisionit shqiptar për rregullimin e marrëdhënieve shqiptare nga senatorët dhe deputetët shqiptarë, ku ishin edhe Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Mufid Gjirokastra (Libohova-H.L.) etj. Duket se ka qenë ndikimi i këtij

³⁸⁶ Xhafer Belegu, *Lidhja e Prizrenit*, Tiranë.1939, faqe.38-39

komisioni, që më 20 korrik 1908, u arrit një marrëveshje në të cilën përcaktohej se shqiptarët të përkrahin luftën e turqve të rinj kundër absolutizmit hamidian, por me kusht që t'u plotësohen kërkesat për vetëqeverisje, si dhe të vendosej kthimi i kushtetues së vitit 1876. Mehmet Deralla në këtë komision, çuditërisht, ka qenë në përkrahje të padishahut dhe jo në mbështetje të revolucionit xhonturk, kundër grupit të Isa Boletinit e Bajram Currit, që mbështetnin programin e komitetit "Bashkim e Përparim". Zekeria Cana këtë të dhënë e ka shprehur pak më ndryshe: "Midis përfaqësuesve të shtresës feudale dhe prijësve të turmave fshatare dolën shpejt mospajtime lidhur me marrjen e qëndrimit ndaj padishahut dhe revolucionit xhonturk. Kur në Ferizaj arritën edhe përfaqësuesit e Prishtinës dhe të Shkupit, rryma e dytë i forcoi pozitat e veta, kështu që Galip beu ia doli t'i bindte pjesëmarrësit e Kuvendit (Ferizaj-H.L) që ta pranonin programin xhonturk, duke u dhënë sigurime se, me vendosjen e rendit kushtetues, do të eliminohej dominimi ekonomik dhe politik i shteteve të mëdha, arbitrarizmi i aparatit administrativ, pastaj se nuk do të kishte më burgje, tagra dhe tatime, se do vihej gisht në zbatimin e reformave të planifikuara, ndërsa oficerët e huaj do të largoheshin përgjithmonë". Trysnia e madhe që ushtri popullsia e vilajetit të Kosovës detyroi Sulltanin, më 23 korrik 1908, të kthente kushtetutën e viti 1876 dhe të urdhëronte zgjedhjet në vend. Duke qenë se kjo kërkesë kënaqte pjesën më të madhe të parisë e të popullsisë, u mirëprit në të gjitha trevat shqiptare, madje edhe në Tetovë, ku u kthye edhe Halim bej Tetova, i biri i Mehmet Derallës, i shoqëruar me rreth 100-150 shqiptarë. Për hir të së vërtetës duhet theksuar se ndryshe nga paria tjetër e vilajetit të Kosovës, vetëm Mehmet pashë Deralla pati fatin të përkrahej nga qeveria turke në vitet në vijim, në emër të plotësimit të kërkesave të shqiptarëve. Sipas Tajar Zavalanit, "qeveria e Stambollit dha prova se e kishte me gjithë mend, duke emëruar Mehmet pashë Derallën si prefekt në Prizren dhe Hasan Tahsin pashën si guvernator (vali) në Janinë". Në fillim të vitit 1912, në "Arabati Baba Teqe" të Tetovës, u mbajt takimi konsultativ për

përgatitjen e përgjithshme, kryesuar nga Mehmet pashë Deralla, e cila përkoi me shpalljen e zgjedhjeve parlamentare nga xhonturqit, më 15 janar 1912. Në këto zgjedhje, Mehmet pashë Deralla u caktua kandidat për deputet në parlamentin xhonturk. Ndërkohë, i biri i Mehmet pashës, Mynipi, i bëri atentat komandantit të garnizonit të Tetovës, çfarë tensionoi më shumë situatën në Tetovë. Në 23 korrik 1912, Mehmet Deralla shkoi në Gjilan, ku u takuan 70 prijës luftëtarësh shqiptarë të Kosovës, dhe ku u hodh ideja e autonomisë dhe e marrjes së Shkupit. Në vijim të këtyre takimeve, Deralla, me një delegacion prej 12 vetash (8 tetovarë dhe 4 gostivaras) ka shkuar në mbledhjen e Prishtinës, ku u diskutua mbledhja e ndihmave popullore për kryengritjen e përgjithshme. Në tetor 1912 i ka propozuar Zeqi Pashës, komandantit turk në Tetovë, për organizimin e mbrojtjes me forca të përbashkëta të qytetit nga sulmet e ushtrisë serbe, por kjo nuk u pranua nga Zeqi Pashai. Gjithsesi, deri më 27 tetor mbrojtja u organizua e përbashkët, por atë ditë forcat turke të korpusit VII lëshuan Tetovën e Gostivarin, duke lëvizur drejt Kërçovës. Edhe Mehmet Deralla, duke vlerësuar rrezikun serb, u tërhoq nga Tetova dhe me gjithë familjen mori rrugën për Dibër të Madhe, ku ndodheshin Isa Boletini, Elez Isufi, Ajdin Draga e shumë luftëtarë shqiptarë. Në këtë krizë, Mehmet Pashë Deralla u kap nga forcat okupatore dhe u internua në shkretëtirat e Irakut prej nga u kthye aty nga viti 1908, falë një amnistie të përgjithshme që u dha pas kryengritjes xhon-turke. Në situatën e mëvonshme, Mehmet Derallës iu ofrua një funksion i lartë në ushtrinë osmane, por ai e refuzoi, duke vënë në dukje se tanimë i përkiste një tjetër kauze që kishte të bënte me idealin kombëtar. Roli i Mehmet Pashë Derallës në organizimin dhe drejtimin e kryengritjeve të mëdha të Kosovës të viteve 1910, 1911 dhe 1912, ishte i madh, këto beteja që kulmuan me atë të verës së vitit 1912, e cila shënoi marrjen e Shkupit, ish- qendrës së vilajetit të Kosovës. Kryengritësit shqiptarë, tashmë tronditën tërë mjedisin ballkanik, në të cilin faktori shqiptar filloi të bëhej dominues. Në fokusin e lëvizjes së tyre, u vendos në këtë periudhë shpërfillja e hegjemonizmit të shteteve

fqinje siç ishte, Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Greqia, të cilat prej kohësh investonin për strategjinë e tyre që kishte të bënte me mohimin e ekzistencës së kombit shqiptar, në mënyrë që të zgjeronin territoret e tyre. Gjenerali Deralla ishte një nga protagonistët kryesorë të qëndresës shekullore përballë sulmeve serbo-malazeze, të cilat synonin pushtimin e Shqipërisë veriore, nën komandën e tij, luftëtarët shqiptarë e ndalën vrullin e forcave serbe në hapësirën ndërmjet Drinit të Bardhë e Drinit të Zi. “Komanda e lartë turke që akoma po mbahej në Manastir ka dërguar komandant në Dibër Mehmet Pashë Derallën, pa asnjë ushtar, që me popullin t’i priste hovin ushtrisë serbe, gjersa trupat e saj të arrinin Janinën.”³⁸⁷ Çka tregon edhe një herë për aftësitë ushtarake të këtij njeriu, të cilit i besohet se do ta kryente detyrën e tij edhe i vetëm, duke pasur mbështetje në popull dhe duke i besuar instinkteve të tij ushtarake.

Në zanafillën e shtetit të ri shqiptar, me shpalljen e Pavarësisë Kombëtare më 28 nëntor 1912, Kuvendi i mbledhur në Vlorë e në të cilin merrnin pjesë përfaqësues nga të gjitha viset shqiptare, ministër i Mbrojtjes i qeverisë së kryesuar nga Ismail Qemali, qe Mehmet Pashë Deralla, i propozuar në këtë post të lartë nga Isa Boletini [flitet se një propozim i është bërë edhe Isa Boletinit për të qenë ministër luftime, por duke qenë se ishte akoma i ri për të luftuar, ai propozoi një nga njerëzit më të besuar edhe më të përgatitur për sa i përket anës ushtarake]. Gjatë kohës dhe në shumë dokumente arkivore të kohës, Deralla quhej dhe Kalkandeleli, emërtim i Tetovës ku ai ishte lindur. Dita e festës kombëtare të Ushtrisë, 4 dhjetor 1912, kohë në të cilën qe ministër Mbrojtjeje, lidhet me emrin dhe kontributin e Mehmet Derallës. Më 21 nëntor, Mehmet Pashë Deralla, nga Dibra vazhdoi rrugën për në Vlorë e jo për në Durrës, siç ishin njoftuar më parë. Grupi delegatëve rrugëtoi nga Dibra në Borovë, në Rupnik, në Librazhd, në Elbasan, vijoi në Belsh (nëpër Dumre), në Lushnjë, në Imeshtë, në Mbrostar, në Fier dhe në

³⁸⁷ Skënder Luarasi, *Tri jetë, Koloneli Tomson, Ismail Qemali, Isa Boletini*, Bot: Migjeni, faqe.297

Vlorë. Gjenerali Mehmet Deralla ka qenë i planifikuar nga kryetari i qeverisë, Ismail Qemali, për t'u caktuar ministër i Luftës pa u votuar, por delegatët kërkuan që procedura të kryhet me votim të fshehtë. Në votimin e kuvendit për ministrat, 69 vjeçari Mehmet Deralla fitoi që në raundin e parë 42 vota nga 58 votues, dhe u rendit i treti, pas Luigj Gurakuqit dhe Mufid Libohovës, [Mehmet Deralla u zgjodh më 4 dhjetor 1912, si Ministër i Mbrojtjes]. Në atë kuvend historik u themelua edhe Qeveria e Përkohshme e Vlorës, e përbërë prej personaliteteve, si: Ismail Qemali – kryeministër dhe ministër i Jashtëm, Dom Nikoll Kaçorri – zëvendëskryeministër, Myfit bej Libohova – ministër i Brendshëm, Gjeneral Mehmet Pashë Deralla – ministër i Luftës³⁸⁸, Abdi bej Toptani – ministër i Financave, Dr. Petro Poga – ministër i Drejtësisë dhe i Sistemit Gjyqësor, Dr. Luigj Gurakuqi – ministër i Arsimit, Mit'hat Bej Frashëri – ministër i Punëve Publike, Pandeli Cale – ministër i Agrikulturës, Lef Nosi – ministër i Post-Telegrafit. Mehmet Deralla³⁸⁹, në postin e ministrit të Luftës, pati një nga detyrat më të vështira ndër gjithë ministrat. Nga ky moment historik e solemn, ai do të bëhej ideatori dhe frymëzuesi i të gjitha përpjekjeve në luftën me armë në dorë kundër okupatorëve ballkanikë, që synonin ta copëtonin vendin tonë në atë periudhë. Gjeneral Deralla në një kohë të shkurtër krijoi strukturat e para me trupat vullnetare dhe siguroi sovranitetin e Qeverisë së Vlorës brenda dhe jashtë vendit, duke përlligjur njëherësh edhe një mbrojtje diplomatike e ushtarake të Fuqive të Mëdha të Evropës kundër synimeve hegjemoniste të fqinjëve shovinistë ballkanikë. Për gati dy vite, Deralla kreu me përkushtim e atdhetari shembullore detyrën e ministrit të Ushtrisë e të Luftës. Zhvillimet politiko-ushtarake në ditët e shpalljes së pavarësisë janë pasqyruar më gjerësisht në jetëshkrimin e Ismail Qemalit, por vlen të evidentohet se pashai tetovar, me grupin e kosovarëve mori mbi vete barrën e rëndë të mbrojtjes së qeverisë së parë

³⁸⁸ Universiteti Shtetëror I Tiranës, *Mbi Lëvizjen Komëbtare Shqiptare*, Tiranë. 1962, faqe.100

AQSH, F.71, dos.1, dok, Nr.8002

³⁸⁹ Darling I.Vlora, *Shqipëria dhe Shqiptarët, Ismail Qemal Bej Vlora*, faqe.128

të shtetit të ri shqiptar, duke mos pasur asnjë strukturë të mirëfilltë, përveç vullnetarëve dhe mbështetësve të tyre. Ismail Qemalin kërkonte në këtë kohë që përmbushte konditat e caktuara që duhet të përmbushnin ministrat që të kënaqë Evropën më një anë dhe Stambollin me tjetrën, duhen të jenë emra të njohur në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë. "Pas kësaj Zotëria e tij nxori përpara një listë si projekt. Në këtë listë figurojnë këta emra Mehmet Pashë Tetova, Myfit Bej Gjinokastra, Azis Pasha, Vehbi Efendiu, Abdi Bej Toptani, Mi-hat Bej Frashëri."³⁹⁰ Kjo tregon edhe një herë se emri i Mehmet Derallës është ndër të parët që flitet për një njohje të brendshme edhe të jashtme, çka tregon se veprimtaria e tij ishte tashmë shumë e madhe, edhe rëndësia për vendin ishte përsëri e madhe që ai t'i shërbente më të gjitha njohuritë që kishte.

Situata kërkonte masa urgjente për të ndaluar serbët që marshonin në brendësi të Shqipërisë së Mesme, ndalimin e shovinistëve grekë që po sulmonin Himarën dhe synonin të merrnin Vlorën. Urgjente shtrohej detyra të vihej në funksionim Shtabi i Përgjithshëm, i drejtuar prej Ali Shefqet Shkupit, të organizoheshin e mobilizoheshin repartet, të hartoheshin aktet ligjore, të rekrutoheshin oficerët e aftë me ndjenja atdhetarie që kishin shërbyer në ushtrinë perandorake, të mos lejohej dezertimi i rezervistëve dhe të mos rrëmbeheshin armët prej tyre. Masat e shpejta që u morën për organizimin e ushtrisë, policisë, xhandarmërisë e në veçanti të milicisë më 3 qershor 1912, padyshim që mbajnë mbi vete mendjen dhe kontributin e shquar të gjeneralit Mehmet Pashë Deralla. Plaku i urtë, por me zemër luftarake afroi rreth vetes rreth 70 oficerë dhe 150 nënoficerë që kishin shërbyer në ushtrinë turke dhe ishin të shkolluar, duke krijuar bërthamën rreth së cilës do të mblidheshin shqiptarë të ndershëm për të plotësuar radhët e Forcave të Armatosura

³⁹⁰ Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave Shtetërore të R.P.Sh, *Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, (nëntor 1912-janar 1914)*, Tiranë. 1963, faqe.52

dhe krijimin e ushtrisë së rregullt shqiptare.³⁹¹ Të parët që erdhën nën komandën e tij kanë qenë ushtarakët Ismail Haki Tatzati, Rexhep Shala, Mustafa Maksuti, Mustafa Aranitasi, Ali Fehmi Kosturi, Hysen Prishtina etj. Është meritë e Mehmet Derallës që mundi të organizojë Komandën e Përgjithshme dhe Shtabin Madhor me strukturat përkatëse dhe në varësi të tyre strukturat në prefektura e nënprefektura, komuna e fshatra. Ai, ndonëse ishte kreu i ministrisë së Luftës, nuk nguroi të kontribuojë në hartimin e “Rregullores për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës”, më 13 prill 1913 dhe “Rregullores së Qeverisë së përkohshme mbi formimin e Milicisë Shqiptare”, më 3 qershor 1913. Duket se nga Qeveria Provizore e Shqipërisë, e veçanërisht nga gjenerali i Luftës, Mehmet Deralla, në atë kohë ishte vlerësuar si parësore organizimi i strukturës së Milicisë shqiptare, të cilës iu dhanë kompetenca edhe për ruajtjen e rendit e të qetësisë publike. Rregullorja “Milicia Shqiptare”³⁹², i përcaktonte asaj misionin “për mbrojtjen e vendit deri sa të formohet ushtria e rregullt”. Ajo (Milicia) do të jetë në varësi të ministrit të Luftës, si strukturë ushtarake. Sipas kësaj rregulloreje, “çdo prefekturë do të konsiderohet si brigadë, ndërsa çdo nënprefekturë - një batalion, kurse komunat sa një kompani. Kjo rregullore detyron punonjësit e Policisë të ndihmojnë në rast nevojë oficerët e Milicisë. Rregullorja përcaktonte detyrime për Policinë, teksa thekson se ajo angazhohet me detyra “për të mbledhur milicët për qëllime stërvitje ose lufte, apo shoqërimin e tyre në gjendje arresti, kur thirrja ishte për nevoja lufte”. Sipas këtij detyrimi ligjor kuptohet se qeveria, Policinë, ashtu sikurse edhe Xhandarmërinë e konsideronte në këtë kohë strukturë të besueshme e të sigurt për zbatimin e detyrave të qetësisë e rregullit dhe për më tepër për forcimin e zbatimit me imponim të akteve administrative të saj, çka do të ndikonte dukshëm në publik. Krahas kësaj, ministri i Luftës, si personi kryesor përgjegjës për mbrojtjen e vendit, mundi të përgatisë aktin ligjor për “Formimin e një Xhandarmërie Shqiptare në krahinat e Jugut”, me

³⁹¹ Gaz, Përlindja e Shqypnisë, dt.4-7 shkurt 1914, Nr.7,8, “Organi zyrtar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës”.

³⁹² Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave Shtetërore të R.P.Sh, *vep e përmendur*. faqe.146

mision marrjen në zotërim të territoreve në juridiksionin e saj dhe mbajtjen e rendit e të qetësisë në ato krahina". Sipas dekretit, lejohej që xhandarët që nuk do të kenë uniformë të mbajnë si shenjë "një mëngë të kuqe me një vijë të zezë". Shtypi i asaj kohe shkroi se Ministri i Luftës, Mehmet pashë Deralla, i ndihmuar nga oficerët holandezë, koloneli De Veer, formoi një xhandarmëri me afërsisht pesë mijë vetë, veshur me uniformë të përafërt me atë italiane. Në vijim, në dokumentin normativ, përcaktohej: detyrimi për bindje ndaj eprorëve, pranimi do të jetë me kontratë 5-mujore, për vlerësim në vijim të shërbimit, duke u dhënë kompetencë eprorëve për të larguar para kohe ata që nuk plotësojnë kontratën. Dekreti përcaktonte se "edhe oficerët do të jenë me kontratë 6-mujore". Dekreti përmbante edhe rregulla për disiplinën, ndëshkimet, organizimit të këshillit disiplinor dhe këshillit të luftës. Akti u miratua më 3 dhjetor 1913, nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës, por në këtë kohë ministri Deralla pati dhënë dorëheqjen nga kabineti qeveritar. Të saktësojmë faktin se në atë periudhë pati një "ftohje" në marrëdhëniet Mehmet pashë Deralla-Ismael bej Qemal Vlora, aq sa që në dhjetor Pashai tetovar u largua nga Qeveria e Vlorës, [vendin e tij e zuri Esad Toptani]. Mehmet pashë Deralla qëndroi në Durrës, pranë Esad Toptanit, nuk u largua nga Shqipëria, por priti princ Wied-in, të cilin e ka shoqëruar në takimin që ai organizoi "me ushtrinë kosovare në kazermat e Durrësit, në qershor 1914. Fillimisht, në kohën e Wied-it, pashai tetovar u caktua prefekt i Elbasanit, në vendin që lëshoi patrioti Aqif Pashë Biçaku. Rrethanat nuk lejuan Wied-in të punonte i qetë, madje në një rast ai u detyrua të shkonte në anije, për t'u larguar dhe shpëtuar rrezikut nga kryengritësit. Kur kryengritësit morën vesh për këtë fakt i çuan fjalë Wied-it se nuk do t'i bënin gjë nëse ai do të kthehej në pallatin e tij dhe të bisedonte me ata si burrë. Duke marrë këto garanci, Wiedi u kthye në pallat. Shqiptarët që tashmë kishin peng të tyre gjeneralin holandez Saar dhe princ Sturdzen (atasheun rumun në Shqipëri) dhe mbanin të rrethuar Durrësin, i liruan këta të fundit dhe i çuan te Wiedi që t'i çonin atij fjalë që të shpallte amnisti të përgjithshme

dhe që Komisioni Internacional që po ia shiste Shqipërinë grekut, të shkonte dhe të takohej me ata për të biseduar fatet e Shqipërisë. Pasi Wiedi ra dakord me kërkesat e shqiptarëve, iu çoi atyre nën flamurin italian Mehmet Pashë Derallën si përfaqësues të Komisionit Ndërkombëtar, që të hynte në bisedime në Shijak. Pas takimit të parë me Derallën, Komisioni Ndërkombëtar i vizitoi kryengritësit shqiptarë sërish më 28 maj 1914 në Shijak. Në këtë takim, patriotët shqiptarë u kërkuan ndërkombëtareve që të investonin në Shqipëri, të ndërtonin rrugë, shkolla, rregull dhe që Shqipërinë ta linin nën mbrojtjen e Turqisë apo të një princi mysliman. Disa ditë më vonë, ky komitet vizitoi edhe Kavajën, ku u prit mirë si në Shijak. Për marrëdhëniet e Derallës me kryengritësit e Shqipërisë së Mesme, burime të ndryshme japin të dhëna që nuk përputhen me njëra-tjetrën, tregojnë se Mehmet Pashë Deralla ka kërkuar që të bëjë një takim me kryengritësit për të biseduar, “kryengritësit iu drejtuan disa herë kërësve të kosovarëve të grumbulluar në Durrës për bisedime, duke shpresuar se do të mund të arrinin bashkëpunimin me ta. H.Prishtina, I.Boletini e B.Curri nuk iu përgjigjën këtyre thirrjeve. Në bisedime u paraqitën Mehmet pashë Deralla, Dr.I.Temoja e dy durrsakë të tjerë.”³⁹³ Kjo tregon edhe një herë cilësitë e këtij njeriu, i cili në kokën e tij kishte edhe hapësira për të biseduar edhe jo vetëm për të luftuar.

Largimi i Wied-it nga Durrësi dhe Shqipëria, më 3 shtator 1914, solli krijimin e një situatë të vështirë për qëndrimin e patriotëve të çështjes kombëtare në Durrës, ndaj gradualisht të gjithë morën rrugën për Shkodër. Në një nga raportet e shumta të austro-hungarezëve në këtë kohë, fliste edhe për kërkesat për mbrojtje edhe përkrahje që Mehmet pasha bënte që të krijonte një situatë sa më të qetë në vendlindjen e tij në Tetovë. Raport i atasheut konsullor në Durrës, Horbostel, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, mbi situatën politike dhe gjendjen e

³⁹³ ASHSH, IH, Gazmend Shpuza, *Kryengritja fshatare e Shqipërisë së Mesme 1914-1915*, faqe.165

mjeruar të popullsisë në kufirin lindor, sipas konstatimeve të kolonelit Murikio.

Nr.30

Durrës, më 24 shkurt 1914

“Koloneli Murikio më vizitoi disa ditë pas kthimit të tij nga Dibra dhe më bëri me dije rreth zhvillimit të misionit të tij, si dhe konstatimet personale, deklaratat që vijnë. Me vështirësi të jashtëzakonshme, për shkak të kushteve tepër të disfavourshme të momentit të keq, mundën që të sillen pas shumë javësh 250 çadra në Drin, duke i kaluar qafën e Murizës dhe të Bulqizës. Koloneli Murikio ndërtoi tri depo. Prej këtej u bë shpërndarja e çadrave, për në Homesh (në perëndim të Drinit) Maqellar dhe Peshkopi (në lindje të Drinit, në Dibrën e vogël). Në këto krahina popullsia ndodhej në mjerim të papërshkrueshëm, pasi atyre u mungonin sendet ushqimore, veshjet si dhe lënda djegëse. Mbi pozicionet e serbëve në kufi, koloneli Murikia më tha sa vijon; Xhandarët serbë ndodhen në Banishtë, një lokalitet që në fillim banohej nga bullgarë, në Kirlevca dhe në Shushicë, ndërsa lokalitetet Spas, Selekiki, Konjari janë të zbrazur. Në rrethet e këtyre lokaliteteve është përhapur fjalë se Serbia do të heq dorë nga qyteti i Dibrës. Siç duket, kjo kishte qenë një manovër e serbëve, për të tërhequr fshatarësinë që të vendoset në qytetin e zbrazur nga popullsia. Pozicioni i serbëve në Veri ka avancuar deri në Merini, në Drinin e bardhë dhe në Topojan. Emigrantët nga Tropojani dhe nga rrethet janë vendosur në Buzmagaz. Koloneli Murikio është i mendimit se lokaliteti Banishtë, që u përmend më sipër (në veriperëndim të Dibrës), për shkak të pozicionit të tij dhe të burimeve termale që ndodhen afër, do të bëhet një qendër tregtare në luginën e Drinit dhe do të arrijë që të ketë rëndësinë e dikurshme të Dibrës. Ndërmjet të shpërngulurit ndodhen edhe shumë nga paria që janë pasanikë tokash, të cilët nuk kanë mundësi që të shesin tokat e tyre, t’i japin me qira ose t’i punojnë vetë. Dje u paraqit para kolegut tim italian një delegacion i përbërë nga kjo parësi, ndërmjet tyre edhe

Mehmet pasha Deralla, të cilët u lutën që t'u propozojë qeverive tona çështja e mbrojtjes së pasurisë së tyre e ndodhur në pjesën e Serbisë, respektivisht në territorin grek. Parësia e Dibrës ka shumë pasuri në rrethin e Tetovës (Mehmet pashë Deralla) në Përlep, Resnjë, Manastir, por edhe në Serres dhe në Kavallë). Deri më sot ata jetonin me të ardhurat e çifligjeve të tyre, tani qëndrojnë të pafuqishëm para këtij mjerimi. Unë i premtova delegacionit se lutjet e tij gati të pamundur për t'u marrë parasysh, do t'ia parashtroja qeverisë time dhe shfrytëzova rastin për t'i bindur që të evitonin çdo aksion, i cili do t'u jepte serbëve pretekstin e dëshiruar për t'iu përgjigjur një kundërsioni. Unë i vura parisë në dukje në mënyrë të veçantë rrezikun e aksioneve të çetave dhe të banditizmit në territorin serb, pasi në kohën e fundit isha informuar se nga emigrantët e Kosovës do të formoheshin çeta, me sa duket me nxitjen e parisë që ndodhet këtu (probabilisht nga Hasan bej Prishtina). Një kopje Romës, Shkodrës, Vlorës dhe konsullit të përgjithshëm Petroviç në Vlorë në Nr.260, datë 24 shkurt 1914." 394

Një tjetër sfidë e priste gjeneralin e Ismail Qemalit pas kësaj, ndërkohë që kishte filluar shpërthimi i Luftës së Parë Botërore dhe trupat shoviniste serbe ishin futur në thellësi të territoreve shqiptare. Pikërisht në këtë periudhë ai do të vihej në krye të qëndresës në luftën kundër serbëve, duke u prirë luftëtarëve kosovarë në beteja të njëpasnjëshme. Fqinjët e shqiptarëve, serbët, malazezët, bullgarët dhe grekët, të mbështetur nga Rusia cariste dhe jo vetëm prej saj, bëjnë si hiena për t'i grabitur trojet shqiptare. Pas Kongresit të Berlinit, mbi shqiptarët pasuan gërrshërët e Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1912-13). Mehmet Deralla është jo vetëm bashkëkohës i këtyre ngjarjeve dramatike për kombin, por edhe strateg dhe luftëtar sypatrembur, në krye të betejave për mbrojtjen e vendit. Në vitin 1913, Mehmet Deralla është një ndër ushtarakët dhe protagonistët kryesorë edhe në kryengritjen e shtatorit të vitit 1913, kundër pushtuesve serbë dhe malazezë, të cilët synonin ta

³⁹⁴ AIH, Vj. 24-13-1302.

pushtonin veriun e Shqipërisë. Nën komandën e tij, kryengritësit shqiptarë arritën t'i s'prapsin forcat serbe në zonën midis Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi. Ishte kjo kryengritja e parë, me përmasa të gjera, që popullsia e Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare të aneksuara nga Serbia dhe Mali i Zi, ndërmori për t'u çliruar nga zgjedha serbo-malazeze dhe për t'u bashkuar me shtetin e pavarur shqiptar. Kjo kryengritje kundërserbe u ndërmor për shkak të copëtimit të Shqipërisë nga Konferenca e Ambasadorëve, si dhe politikës së dhunës, të shfarosjes dhe të shpërnguljes së popullsisë shqiptare, që Serbia dhe Mali i Zi i zbatuan në territoret e aneksuara të Kosovës dhe në viset lindore dhe veriore të Shqipërisë. Mehmet Deralla qëndronte krahu organizatorëve të kryengritjes – Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Isa Boletinit, Elez Isufit etj. Në nëntor të vitit 1915 në Gradec të Tetovës, serbët kryen një gjenocid të vërtetë, ku u vranë 150 vetë, ndërmjet të cilëve 9 burra nga Derallajt. Në vitin 1916, Mehmet Deralla u burgos nga Serbia. Një vit e gjysmë qëndroi në kazamatet e Beogradit dhe të Podgoricës, ku sipas disa studiuesve, më 1918 gjeti vdekjen me helmim. Por, ka studiues të tjerë që thonë se ky strateg i luftës ka ndërruar jetë në Tetovë dhe është varrosur në Teqenë Harabati Baba të këtij qyteti. Varri i tij në këtë teqe, nuk dihet. Ka pasur studiues që kanë thënë se Mehmet Deralla ka vdekur në Shkodër.

Mehmet Pashë Deralla është njohur edhe me katër mbiemra të tjerë: Tetova, Kallkandeleli, Ruzhdija e Kosova. Kur ishte i internuar në Bagdad, diplomati i shquar austro-hungarez, konti Berthold pati shkruar: "...I internuari politik Mehmet Pashë Deralla, është një burrë me tipare të theksuara shqiptare, i pajisur me kulturë të gjerë dhe ndjenja të pastra kombëtare..." Kur do të zgjidhej qeveria, dhe Ismail Qemali ishte shprehur se ministria e Luftës i takon Kosovës, trimi me zemër baruti, Isa Boletini, u shpreh me sinqeritet e gjithë fisnikëri: "Në qeveri duhet të ketë njerëz me shkollë. Posti i ministrit të luftës i takon Mehmet Derallës". Në vendlindje, në Gradec, më 28 nëntor 2011, u vendos busti në sheshin që mban emrin e tij, në qendër të vendbanimit.

Po aty është edhe një shkollë me emrin SH.F.Q “Mehmet Deralla”. Presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, në vizitën homazh para lapidarit të tij në Tetovë, në prill 2012, e quajti Mehmet Pashë Derallën: “Një nga figurat më të ndritura të historisë së kombit shqiptar, të shtetit të ri shqiptar...një nga patriotët më të mëdhenj të kombit tonë...ndër të parët që u vu në krah të Ismail Qemalit për të krijuar pavarësinë e shtetit shqiptar...një nga figurat më eminente dhe heroike kombëtare në përpjekjet për krijimin e shtetit shqiptar, sot e 100 vite më parë”. Mehmet Hasan Deralla, pas vdekjes, u dekorua nga presidenti i Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha, në nëntorin e vitit 1992, me “Urdhrin për veprimtari patriotike të klasit I”, me motivacionin, “Si komandant i njohur i forcave kryengritëse të viteve 1910-1912 dhe si ministër i Luftës në Qeverinë e Përkohshme të Vlorës, ka dhënë një kontribut të shquar në krijimin dhe organizimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare”.

Bibliografia

Xhafer Belegu, Lidhja e Prizrenit, Tiranë.1939

Skënder Luarasi, Tri jetë, Koloneli Tomson, Ismail Qemali, Isa Boletini, Bot; Migjeni

Universiteti Shtetëror i Tiranës, Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, Tiranë. 1962

AQSH, F.71, dos.1, dok, Nr.8002

Darling I.Vlora, Shqipëria dhe Shqiptarët, Ismail Qemal Bej Vlora

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave Shtetërore të R.P.Sh, Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj,(nëntor 1912-janar 1914), Tiranë. 1963

Gaz, Përlindja e Shqypnisë, dt.4-7 shkurt 1914, Nr.7,8, "Organi zyrtarë i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës".

ASHSH, IH, Gazmend Shpuza, Kryengritja fshatare e Shqipërisë së Mesme 1914-1915.

AIH, Vj. 24-13-1302

Top of Form

Bottom of Form